



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 276/3 Prot.

Tiranë, më 26.11.2025

**VENDIM**

Nr. 349, datë 13.11.2025

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL  
PËR PROKURORIN ESMERALDA KESHI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

|                    |                      |
|--------------------|----------------------|
| 1. Mirela BOGDANI  | Kryetar (në mungesë) |
| 2. Erind GERMENJI  | Zv/kryetar           |
| 3. Sokol STOJANI   | Anëtar               |
| 4. Zeqir HODA      | Anëtar               |
| 5. Arta MANDRO     | Anëtar               |
| 6. Ledina RIZA     | Anëtar               |
| 7. Moisi DUDA      | Anëtar               |
| 8. Vatë STAKA      | Anëtar (në mungesë)  |
| 9. Olger EMINAJ    | Anëtar               |
| 10. Erind MERKURI  | Anëtar               |
| 11. Erion FEJZULLA | Anëtar               |

Mbështetur në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenin 95, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 159, 161, 164, pika 8, 184, germa “dh”, 189, pika 1, germa “a” dhe 190, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në Rregulloren “Për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve”, e ndryshuar, dhe pasi u njoh me projektraportin e përgatitur nga Relatori, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Raportit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit Esmeralda Keshi, për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, duke e vlerësuar si më poshtë:
  - a. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm” – 100 (njëqind) pikë;
  - b. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm” – 100 (njëqind) pikë;

c. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – Shkëlqyeshëm – 100 (njëqind) pikë;

d. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm” – 95 (nëntëdhjetë e pesë) pikë.

- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm” – 395 (treqind e nëntëdhjetë e pesë) pikë.

2. Raporti i vlerësimit sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, vetëm për shkelje të rënda procedurale.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në përputhje me nenin 95, pika 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar.

U shpall në Tiranë, sot më 13.11.2025.

#### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**ZV/KRYETAR**  
**Erind Gërmenji**

**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Arta Mandro**

**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

**ANËTAR**  
**Moisi Duda**

**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**

**ANËTAR**  
**Erind Merkuri**

**ANËTAR**  
**Erion Fejzulla**